

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTERISE TIRANE

NR. 77 Rep

NR. 16 Kol

KONTRATE SHITJE AKSIONESH

Sot me datë 04.04.2006 (Dy mijë e gjashtë) para meje Noteres *Thoma Minga e pulles pague* në Tiranë, u paraqiten personalisht palët dhe më kërkuan redaktimin e kësaj kontrate shitje aksionesh.

**SHITËSI:** **Z. Ilir Goci**, i biri i Haxhiut dhe i Nadires, i dtl. 1955, lindur në Krujë me pasaportë Nr. 1996225, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, banues në Tiranë,

**BLERËSI:** **Z. Thoma Minga**, i biri i Vasilit, i dtl. 1954, lindur në Librazhd, me letërnjoftim EV Nr 210531 madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Shitësi **Ilir Goci** është aksioner themelues i shoqërisë në bazë të Aktit të Themelimit të Shoqërisë "MEDIASAT" SHA, i përpiluar në datën 08.05.2000 dhe mbajtës i 10% të aksioneve të kapitalit themeltar të shoqërisë "MEDIASAT" SHA.

Blerësi **Thoma Minga** është aksioner themelues i shoqërisë në bazë të Aktit të Themelimit të Shoqërisë "MEDIASAT" SHA i përpiluar në datën 08.05.2000 dhe mbajtës i 30% të aksioneve të kapitalit themeltar të shoqërisë "MEDIASAT" SHA.

**Z. Thoma Minga** dëshiron të blejë aksionet e **Z. Ilir Goci** të barabartë me 10% të kuotave të kapitalit themeltar të Shoqërisë për shumën **25.000 Lekë**,

Në bazë të Vendimit Nr 16 pika 1, të datës 12. 01.2006 të Mbledhjes së Asamblesë së Jashtëzakonshme të Ortakëve të Shoqërisë "MEDIASAT" SHA:

Shitësi Ilir Goci duke qenë aksioner i shoqërisë dhe mbajtës i 10 % të aksioneve, ia shet aksionet që zotëron Z. Thoma Minga.

Edhe blerësi Z. Thoma Minga është dakort dhe pranon blerjen e kuotave të mësipërme për shumën **25.000 Lekë**, duke zotëruar kështu përfundimisht ai 40% të aksioneve të Shoqërisë "MEDIASAT" SHA.

**Përfundimisht me anë të kësaj kontrate shitje aksionesh, Z. Thoma Minga zotëron 40% të aksioneve të shoqërisë "MEDIASAT" SHA.**

Me nënshkrimin e kësaj kontrate pala shitëse Ilir Goci, humbet të drejtën e aksioneve të shitura, konkretisht, në vlerën totale 10%, ndërsa pala blerëse, bëhet pronare e 40% të aksioneve të Shoqërisë "MEDIASAT" SHA.

Kjo kontrate shitje aksionesh, përpilohet në bazë të Vendimit Nr 16 datë 12.01.2006 të Mbledhjes së Jashtëzakonshme të Asamblesë së Aksionerëve bashkëngjitur kësaj kontrate.

Kontrata u përpilua në katër kopje me vlerë të njëjtë ligjore, i'u lexua palëve kontraktuese me zë të lartë, u kuptua prej tyre dhe meqenëse shprehën vullnetin e tyre të lirë e të plotë u nënshkrua rregullisht prej tyre para meje dhe unë Noterja e vertetoj sipas ligjit.



**SHITËSI**

**BLERËSI**

**Ilir GOCI**

**Thoma MINGA**

*Ilir Goci*, *Thoma Minga*

**NOTERE**

*Ilir Goci*